

Ekzekutivi rikthen për implementim projektin e trotuareve

Arian Duriqi

LIPJAN, 10 SHTATOR - Pas disa reagimeve publike dhe pas një kërkesë të sërishme të shoqërisë civile dhe të qytetarëve, ekzekutivi i Lipjanit me ridestimin e mjeteve buxhetore për vitin 2014 ka riplanifikuar dhe rikthyer ndërtimin e trotuareve në qendër. Një ridestitim mjeteve në lartësi prej 50 mijë eurosh për trotuaret e Lipjanit është aprovuar në mbledhjen e jashtëzakonshme në mesjavë. Këtë veprim e ka përshëndetur edhe shoqëria civile që merret me monitorimin e punës së ekzekutivit, ndërsa është thënë se reagimet kanë risjell ndërtimin e trotuareve sivjet.

"Pas reagimit tonë mbi gjendjen e rëndë të trotuareve në Lipjan dhe për shkak të heqjes së këtij projekti të trotuareve nga buxheti komunal 2014 nga ana e ekzekutivit të Lipjanit, në



mbledhjen e 9-të (të jashtëzakonshme) të Kuvendit Komunal të Lipjanit, ekzekutivi, megjithatë, e rikthen projektin e trotuareve me anë të ridestimitit të mjeteve buxhetore për këtë vit 2014 dhe ne e përshëndesim këtë hap", ka thënë Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në OJQ-në YAHR.

Për më tepër, me një propozim të ekzekutivit komunal kuvendarët shumicë të pushtetit në Lipjan në mbledhjen e parafundit të KK-së patën aprovuar heqjen e një projekti të planifikuar më herët dhe me rëndësi për vetë qendrën e Lipjanit, atë të trotuareve, ndërsa të menjëhershme kishin qenë reagimet e opozitës dhe të shoqërisë civile për këtë veprim. Ndërkohë që, kuvendarët e Lipjanit, të mërkurën, e kanë shfuqizuar rishikimin buxhetor të mbledhjes së kaluar dhe e kanë aprovuar ridestimin e mjeteve buxhetore të kësaj komune për vitin 2014. Në këtë diskutim, drejtori i Buxhetit dhe Financave, Shkëlzen Hajdini, ka deklaruar se ridestinimi vinte pas bllokimit të rishikimit buxhetor nga niveli qendror që kishte ndodhur kohë më parë në këtë komunë.

"Bazuar në Ligjin mbi financat publike, neni 30 paragrafi 2, në paragrafin 5, kryetari ka propozuar vendimin për ridestimin e buxhetit për 2014. Arsyja e këtij ridestinimi është e qartë, sepse në gjithë territorin e vendit nuk ka rishikim buxhetor dhe ai mund të vonohet, ndërsa pa ridestimin ishte e pamundur të implementoheshin projektet kapitale", ka thënë Shkëlzen Hajdini, drejtor i Buxhetit dhe Financave në Lipjan.

© KOHA Ditore

Mehmet S

DRAGASH, 11 SHTATOR - Disa lagjeve periferike të kërkuar nga autoritetet investime në përmirësim të infrastrukturës, e ujit të pijshëm dhe ndriçimit publik, janë në pritje të lemet më të theksuar të vazhdimësi përballë investimit në hyrje të qytetit të Kukajanit e Rrethit të Përqendër të Prizrenit. Në këto shqetësime disa herë zyrtarëve paslufta e këndeve, atëherë të shurdhër, Sitki Sejrani e Fikri të lagjes në hyrje të tyre, në veçanti janë nxënësit e shkollave detyruar të kalojnë rrugë, e cila është e lidh Dragashin me Prizrenin. Po të njëjtit kishte edhe Mahir të lagjes në dalje për Kukaj. Në ditë të ditur se banorët, për krahas institucioneve të detyruar që me zgjidhin disa probleme prehet ai, kjo lagje e mungesën e të ndriçimit publik dhe të detyruar që fëmijë deri në shkollë dhe nga fakti se kjo rrugë rrezikshme për këto disa banorë të Lagjes theksojnë se për këtë është investuar asnjë ndër më të vjetrit e Me sa mbaj mend, j të pijshëm e kana